



# NDËRMJETËS I PASURIVE TË PALUAJTSHME



*Aprovuar nga Ministria e Drejtësisë*

## Përmbajtja e Trajnimit

### Trajnimi

Programi Ndërmjetës i Pasurive të Paluajtshme ka si qëllim aftësimin profesional të Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme dhe certifikimin e tyre me qëllim LICENSIMIN për ushtrimin ligjor të aktivitetit të tyre profesional nga Ministria e Drejtësisë.

### Aftësitë që fitohen:

Aftësitë e duhura profesionale për të lidhur me klientin kontratën për ndërmjetësimin e veprimeve juridike me pasuritë e paluajtshme përmes së cilës ndërmjetësi merr përsipër, sipas kërkesave të klientit, të ndihmojë në realizimin e veprimit juridik të kërkuar, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

- Njohuri mbi Kodin Civil
- Legjislacionin për ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme
- Kodi i Etikës Profesionale të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme
- Detyrimet dhe kontratat në lidhje me pasuritë e paluajtshme
- Njohuri mbi legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.
- E drejta e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme
- Njohuri mbi të drejtën tregtare
- Psikologjia e blerësit dhe teknikat e negocimit
- Gjenerimi i leads, menaxhimi i pronës dhe roli i broker
- Praktikë profesionale

# Mundësitë e Pjesëmarrësve:

Trajnimi, certifikimi dhe licensimi i profesionisteve i rrit mundësitë profesionale për të punuar si profesionistë të licensuar ligjërisht. Ndërmjetësi kryen çdo veprimtari për të ndërmjetësuar përfundimin e një marrëveshjeje, realizimin e veprimit juridik të kalimit të pronësisë së pasurivetë paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to, duke përfshirë edhe publicitetin e kryer nga ndërmjetësi me qëllim promovimin e pasurisë së paluajtshme për palët e treta.

## Kërkesa për këto trajnime:

Për të punuar ligjërisht në këtë fushë duhet të licensohesh nga Ministria e Drejtësisë. Për të marrë licensën përkatëse duhet të keni përfunduar këtë trajnim të detyrueshëm si kriter ligjor për tu pajisur me licencë bazuar në pikën 2, të nenit 9 të Ligjit nr. 9/2022 të Profesionit të Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme, i cili parashikon si kusht licensimi realizimin e Programit të detyrueshëm të trajnimit.

## Rreth Trajnimit:

### MËNYRA E ZHVILLIMIT

Kursi zhvillohet fizikisht pranë ambienteve të Universitetit Barleti, Rr. "Frang Bardhi", Ura e Selitës, Tiranë.

### KOHËZGJATJA:

Kohëzgjatja normale për programin e studimit të vazhduar është 3 muaj (12 javë)

### PERIODICITETI I ZHVILLIMIT:

1 grup çdo 2 muaj.

## KUSH MUND TË MARRË PJESË:

Këtë program trajnimi mund t'a ndjekin të gjithë profesionistët apo të interesuarit që duan të aftësohen në fushën e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç.

## KUR ZHVILLOHET:

Programet zhvillohen kryesisht:

- E martë - 17.00-20.00
- E enjte - 17.00-20

## KOSTO E PJESËMARRJES:

30.000 lekë (Mundësi pagese me 2 këste)

## KUR FILLON:

25 Tetor 2022 ora 17.00

## MËNYRA E REGJISTRIMIT:

Për tu regjistruar paraprakisht na dërgoni të dhënat tuaja në kontaktet e mëposhtme:

- Emër Mbiemër:
- Cel:
- Email:
- Lloji i kursit:

## KONTAKTE:

Brunilda Basha  
+ 355 68 45 96 365  
arch.co@umb.edu.al

Etleva Dobjani  
+ 355 69 40 61 949  
arch.dep@umb.edu.al